

VENDIM
Nr. 1025, datë 16.12.2015

PËR SHËRBIMET E PROMOVIMIT DHE PËRFAQËSIMIT TË INVESTIMEVE
STRATEGJIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 6, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. SHËRBIMET E PROMOVIMIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

1. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve zhvillon dhe blen shërbime të promovimit, nxitjes dhe tërheqjes së investimeve strategjike, duke promovuar klimën e biznesit, procedurat lehtësuese, masat mbështetëse dhe kuadrin ligjor favorizues për investimet strategjike, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Në shërbimet e promovimit përfshihen, por pa u kufizuar, kryerja e veprimtarive të tilla, si marketing, reklama, publicitete, veprimtari dhe materiale informuese, përfshirë publikime në media të shkruara, audio/televizive, si dhe shërbime promovimi në takime, seminare, konferenca, panaire, evente dhe veprimtari kombëtare e ndërkombëtare, ku mund të realizohen më së miri qëllimet e promovimit.

3. Shërbimet e promovimit mund të kryhen nga vetë Agjencia, nëpërmjet stafit të saj, duke përdorur burimet, fondet dhe kapacitetet e saj.

4. Agjencia ka të drejtë të kontraktojë subjekte të specializuara, vendase ose të huaja, për kryerjen e veprimtarive të promovimit të kuadrin ligjor favorizues për investimet strategjike në tregjet ndërkombëtare.

5. Agjencia kontraktin shërbimet e promovimit me palët e treta, sipas kontratave të lidhura në përputhje me parimet dhe rregullat e legjislacionit për prokurimet publike.

II. SHËRBIMET E PËRFAQËSIMIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

1. Agjencia, në emër dhe për llogari të shtetit, mund të kontraktojë në tregjet ndërkombëtare shërbime të përfaqësimit për investimet strategjike, nëpërmjet agentëve ndërkombëtarë të investimeve.

2. Agentët ndërkombëtarë mund të kontaktohen nga vetë Agjencia ose mund të dorëzojnë aplikimet e tyre pranë Agjencisë, me qëllim njohjen e statusit të agentit ndërkombëtar që gëzon të drejtën e ofrimit të shërbimeve të përfaqësimit.

3. Agentët ndërkombëtarë, për kryerjen e shërbimeve të përfaqësimit, identifikohen, vlerësohen dhe përzgjidhen nga Agjencia duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

- a) Të provojnë eksperiencën e tyre për kryerjen e shërbimeve të përfaqësimit;
- b) Të gëzojnë një reputacion të mirë në tregjet ku operojnë;
- c) Të dëshmojnë mungesën e dënimeve penale;
- ç) Të kenë një nivel të lartë morali, etike dhe profesionaliteti.

4. Me qëllim verifikimin e plotësimit të këtyre kriterëve, Agjencia u kërkon agentëve ndërkombëtarë paraqitjen e dokumentacionit, i cili, sipas vlerësimit të Agjencisë, dëshmon përmbushjen e kriterëve të sipërpërmendura.

5. Në rast se Agjencia merr dijeni për mospërmbushjen apo shkeljen e këtyre kriterëve nga agentët ndërkombëtarë, ajo i revokon menjëherë tagrat dhe titullin e përfaqësimit të dhënë në emër të shtetit shqiptar dhe publikon këtë fakt në mënyrë të përshtatshme duke njoftuar, sipas rastit, edhe investitorët potencialë strategjikë të prekur. Agentët mbajnë përgjegjësi penale për deklaratimet e

rreme, fshehjen e të dhënave ose prodhimin e dokumenteve provuese të parregullta.

6. Për përcaktimin e rregullave dhe të mënyrës së kryerjes së shërbimeve të përfaqësimit, Agjencia nënshkruan marrëveshje të posaçme me agjentët ndërkombëtarë të investimeve, në të cilat përcaktohen të drejtat, detyrimet dhe angazhimet e palëve, si dhe afati kohor i mandatit të përfaqësimit.

7. Në marrëveshjet e lidhura për shërbimet e përfaqësimit përcaktohen, midis të tjerash, rregullat e përdorimit të titullit të përfaqësimit, shërbimet e veprimtaritë që do të ndërmerren, si dhe rregullat e etikës e të standardeve profesionale që duhet të zbatojnë agjentët ndërkombëtarë gjatë kryerjes së shërbimeve të përfaqësimit të shtetit.

8. Shërbimet e përfaqësimit të kryera nga agjentë ndërkombëtarë nuk do të kenë kosto në ngarkim të shtetit shqiptar, por mund të përballohen nga vetë investitorët strategjikë, sipas marrëveshjeve të lidhura nga vetë agjentët ndërkombëtarë me investitorët strategjikë. Në asnjë rast, Agjencia nuk merr pjesë si palë dhe nuk merr përsipër detyrime kontraktore në marrëveshjet e lidhura midis agjentëve ndërkombëtarë dhe investitorëve strategjikë.

9. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama